



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.544/13 prot.

Datë 09.04.2025

V E N D I M

Nr. 467/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiovent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.04.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 428/2025, datë 01.04.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-17555-08-30-2024, me objekt *“Dixhitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking”* me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

Ankimues: Operatori ekonomik “INET” SHPK me NIPT K81607039F me adresë Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Ibrahim Rugova Sky Tower, Kati 3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Tirana Parking, me adresë: Rruga “Ali Begeja”, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 01.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 428/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INET” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-17555-08-30-2024, me objekt “Dixhitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking” me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin sipas konstatimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INET” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.47/16 prot., datë 07.04.2025, protokolluar me tonën nr. 544/10 prot., datë 08.04.2025, autoriteti kontraktor Tirana Parking, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 428/2025, datë 01.04.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-17555-08-30-2024, me objekt “Dixhitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking” me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shpresën nr.47/16 prot., datë 07.04.2025, protokolluar me tonën nr. 544/10 prot., datë 08.04.2025, autoriteti kontraktor Tirana Parking, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 428/2025, datë 01.04.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-17555-08-30-2024, me objekt *“Dixhitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking”* me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.

II.2. Referuar shpresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. 47/16 prot., date 07.04.2025 rezulton, se autoriteti kontraktor Tirana Parking informon se ka zbatuar vendimin Nr. 428/2025, datë 01.04.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e operatorëve ekonomik sipas vendimit nr. 428/2025, datë 01.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka pasqyruar vlerësimin në SPE.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin nr. 428/2025, datë 01.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur” me Nr. REF-17555-08-30-2024, me objekt *“Dixhitalizimi i dhënies së shërbimit të parkimit me abonime, shërbimit të rezidentit dhe shërbimit taxi me anë të platformës Tirana Parking”* me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Tirana Parking.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

